




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 712, datë 16/01/2015



PËR
ZHVILLIMIN E PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT
TË ADMINISTRATORËVE TË FALIMENTIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 282/3/b, të ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002, "Për falimentimin", i ndryshuar, të pikës 12, të vendimit nr. 852, datë 21.10.2010, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Mbiqyrjes së Falimentimit, si dhe Urdhërit nr. 4217/2, datë 25/06/2012, të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit për licensimin e administratorëve të falimentimit",

URDHËROJ:

1. Provimi i kualifikimit për marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit të Administratorit të Falimentimit, të zhvillohet më datë **23.02.2015, në orën 11:00**, në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikimet pranë Agjencisë së Mbiqyrjes së Falimentimit, brenda datës 09.02.2015, ora 11:00. Tarifa e pjesmarrjes në provim është 8 000 (tetë mijë) lekë dhe paguhet në llogarinë bankare të Agjencisë së Mbiqyrjes së Falimentimit, Dega e Thesarit Tiranë, Tirana Bank, në numrin e llogarisë 0100-820000-009. Një kopje e mandatit të pagesës i bashkëlidhet aplikimit për pjesmarrje në provim.
3. Kandidatët, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në Urdhërin nr. 4217/2, datë 25.06.2012, "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit për licensimin e administratorëve të falimentit", përfshihen në listën e kandidatëve, të cilët kualifikohen për të marrë pjesë në trajnimin paraprak. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të përcaktuar në Urdhërin e mësipërm dhe publikimi i listës së kandidatëve të kualifikuar bëhet nga Drejtori i Agjencisë së Mbiqyrjes së Falimentimit brenda datës 09.02.2015. Lista afishohet në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Agjencisë së Mbiqyrjes së Falimentimit.
4. Kandidatët e skualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, brenda datës **11.02.2015**. Ministri i Drejtësisë ose një person i autorizuar prej tij vendosin

mbi të brenda datës **13.02.2015**. Vendimi i njoftohet kandidatit dhe Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit.

5. Drejtori i Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit, brenda datës **13.02.2015**, publikon listën përfundimtare të kandidatëve, të cilët kualifikohen për të marrë pjesë në trajnim. Lista afishohet në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit.
6. Trajnimi paraprak do të zhvillohet më datë **16.02.2015**, nga ora 09:00 – 16:30, në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë. Pjesëmarrja në trajnimin paraprak është kusht për pjesëmarrjen në provimin e kualifikimit të administratorëve të falimentimit. Kandidatët e përfshirë në listën e përcaktuar në pikën 6, duhet të bëjnë pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në trajnimin paraprak, në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë, në numrin e llogarisë bankare të Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit, Dega e Thesarit Tiranë, Tirana Bank, në numrin e llogarisë 0100-820000-009. Një kopje të mandatit të pagesës kandidati e depoziton në Agjencinë e Mbikqyrjes së Falimentimit, brenda datës **16.02.2015**.
7. Drejtori i Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit, brenda datës **20.02.2015** miraton listën përfundimtare të kandidatëve, që kualifikohen për të marrë pjesë në provim. Lista afishohet në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë si dhe në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit.
8. Provimi i kualifikimit për marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit të Administratorit të Falimentimit, bazohet në programin e provimit, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
9. Rregullat për organizimin dhe zhvillimin e provimit përcaktohen në Urdhërin 4217/2, datë 25.06.2012, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit për licencimin e administratorëve të falimentimit”.
10. Ky urdhër publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit, menjëherë pas hyrjes në fuqi të tij. Kopje të tij shumëfishohen për t'u tërhequr nga të interesuarit pranë Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit.
11. Ngarkohet Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentimit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
NASIP NAÇO



ANEKS I

Programi për provimin e kualifikimit të Administratorëve të Falimentimit

Kandidatët për Administrator Falimentimi do të testohen për njohuritë e tyre në fushat e mëposhtme:

1. Legjislacioni në fushën e falimentimit në Shqipëri:

- a) Ligji Nr. 8901, datë 23.05.2002 "Për Falimentimin", i ndryshuar;
- b) VKM Nr. 197, datë 13.04.2007 "Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit";
- c) Udhëzim Nr. 22, datë 29.07.2008 i MF dhe MD, "Për caktimin e administratorëve të Përkohshëm të Falimentimit;
- b) Rregullore miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 4217/2, datë 25/06/2012 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit për licensimin e Administratorëve të Falimentimit";
- c) Standardet Kombëtare për Administrimin e Masës së Falimentimit miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 124, datë 06.02.2013

2. Koncepte ekonomike, financiare dhe të kontabilitetit :

- a) Ligji Nr. 9228, datë 29/04/2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- b) Standardet Kombëtare të Kontabilitetit miratuar me Urdhër nr 64, datë 22.07.2014 të Ministrit të Financave "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre"
- c) Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/thesari/standartet-kontabel-nderkombetar/standartet-nderkombetare-te-kontabilitetit-dhe-raportimit-financiar>

3. Njohuri të përgjithshme për legjislacionin shqiptar :

- a) Ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"
- b) Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, "Kodi i Punës"
- c) Ligji nr.8116, datë 29.03.1996, i ndryshuar, "Kodi i Procedurës Civile"
- d) Ligji nr.8485, datë 12.05.1999, i ndryshuar, "Kodi i Procedurave Administrative"
- e) Ligji nr.7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"
- f) Ligji nr.7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar, "Kodi i Procedurës Penale"
- g) Ligji nr.9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- h) Ligji nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- i) Ligji nr.9879 datë 21.02.2008 "Për titujt";
- j) VKM nr.506, datë 01.08.2007 "Për procedurat e regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.